



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

RAPORTI MONITORUES MBI PUNËN E EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT



Shkurt-Qershor 2010

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Premtimet e Kryetarit Shukri Buja,
- Problemet aktuale,
- Përshkrim i realizmit të punëve ,
- Gjendja ekonomike dhe sociale ,
- Transparenca dhe llogaridhënia ,
- Projektet e përcjella për realizim nga viti 2009 ,
- Buxheti i Komunës,
- Investimet kapitale,
- Administrata komunale,
- Komuna e Lipjanit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale,
- Gjendja në arsim,
- Gjendja në shëndetësi,
- Tatimi në pronë,
- Rekomandimet,
- Burimet

Ekipi i Organizatës Joqeveritare Youth Association For Human Rights- YAHR:

Bekim Krasniqi - koordinator i projektit
Mimoza Osmani,
Bahti Sadiku dhe
Antigona Osmani

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan
Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140
e-mail: info.yahr@gmail.com
webfaqja: www.ngoyahr.page.tl & www.ngoyahr.weebly.com



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

Hyrje

Zgjedhjet e Nëntorit të vitit 2007 shënuan herën e parë që kur këshilltarët komunal do të zgjidheshin përmes formës së votimit me lista të hapura, numri i të cilëve përcaktohet në proporcion me votat që ka marr partia të cilën ata e përfaqësojnë. Ndërsa Kryetari i Komunës do të zgjidhet përmes votës së drejtpërdrejtë të qytetarit në zgjedhje të ndara nga ato për këshilltarë, megjithëse me mandat të njëjtë dhe votimet realizohen në të njëjtën kohë. Zgjedhja e Kryetarit të Komunës përmes votës së drejtpërdrejtë i jep Kryetarit më shumë legjitimitet por në të njëjtën kohë edhe më shumë përgjegjësi direkt ndaj qytetarit duke u bazuar në parimet e transparencës dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve përkatësisht taksapaguesve si punëdhënës të tij.

Në mandatin e parë qeverisës për dy vite posti i kryetarit të komunës i ka takuar LDK. Në mandatin e dytë, për pesë vite kryetar komune ka qenë Xhevat Olluri nga PDK. Në zgjedhjet e treta lokale të 17 nëntorit 2007, PDK kishte vendosë që të konkurronte për kryetar me kandidatin e ri Shukri Bujën, i cili i fitoi 8,879 vota apo 41.41%, kurse në raundin e dytë të votimeve i fitoi 10,152 vota apo 63.5%.

Në zgjedhjet e 2009, prapë rizgjedhet për kryetar Shukri Buja nga PDK-ja me 14,336 vota ose me 53,66% pas përsëritjes të zgjedhjeve të raundit të dytë kundër kandidatit Imri Ahmetit nga LDK-ja me 12,380 ose 46,34% të votave

Në hartimin e këtij raporti, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2009/2012 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo tre muaj.

Kryetarët e Komunës së Lipjanit 2000-2010		
Periudha Kohore		Partia Politike
2000-2002	Basri Demiri	LDK
2002-2007	Xhevat Olluri	PDK
2007-2009	Shukri Buja	PDK
2009-2012	Shukri Buja	PDK

Premtimet e Kryetarit Shukri Buja

Organizata Joqeveritare Youth Association For Human Rights - YAHR kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Shukri Buja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor - 14 nëntor 2009 dhe 7 - 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, në mes të tjerash Kryetari Buja ka premtuar

- ✓ Krijimi i zonës së re industriale në Kërqevë për akomodimin e 200 Bizneseve dhe punësimin e 2000 personave,¹
- ✓ Fillimin e ndërtimit të zonës industriale me sipërfaqe 20 ha afër QMI-së dhe punësimin e 800 personave¹
- ✓ Krijimin e Lipjanit si qendër agrobiznese¹
- ✓ Renovimin e të gjitha shkollave dhe krijimin e kushteve hapësinore për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasë nga 37 në 25,¹
- ✓ Rregullimin e parkingjeve publike,¹
- ✓ Zgjerimin e rrugëve kryesore të qytetit në katër korsi të qarkullimit,¹
- ✓ Asfaltimin e rrugëve në të gjitha lagjet e qytetit,¹
- ✓ Krijimin e hapësirave të mjaftueshme të parqeve si dhe parkingjeve publike,¹
- ✓ Futjen e rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrave mbi 150 km
- ✓ Asfaltimin rrjetit rrugor mbi 70 km
- ✓ Sistemin e rrjetit të ujësjellësit mbi 100 km
- ✓ Ndërrimin e pllakave në dyshe, dyerve dhe dritareve në Q.K.M.F në Lipjan
- ✓ Rregullimin e ngrohjes qendrore në Lipjan
- ✓ Zvogëlimin e papunësisë dhe të varfërisë
- ✓ Mbështetjen e ekonomive familjare
- ✓ Riaktivizimin dhe pasurimin e bibliotekave shkollore
- ✓ Hartimin e projekteve bujqësore
- ✓ Rregullimin dhe zgjerimin e sheshit “Adem Jashari”
- ✓ Krijimin e lehtësirave administrative dhe teknike për nxitjen e investimeve të huaja
- ✓ Uljen e taksave mbi investimet që krijojnë vende pune
- ✓ Renovimin e të gjitha shkollave dhe kompletimin me infrastrukturë me qëllim të krijimit të kushteve sipas standardeve evropiane
- ✓ Rregullimin e nxehjes qendrore në të gjitha shkollat dhe rregullimin e rrethove të oborreve të shkollave sipas modelit të shkollës “Mehmet Akif”
- ✓ Përmirësimin e infrastrukturës sportive
- ✓ Sinjalizimin horizontal dhe vertikalë të rrugëve
- ✓ Transporti publik urban dhe ndër urban me mjete transporti uniforme
- ✓ Furnizimi të pandërprerë me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza

¹ Premtime nga programi zgjedhor 2009 i PDK-së nëntor 2009

- ✓ Ndriçimin e të gjitha rrugëve të qytetit
- ✓ Përkrahje e vazhduar e familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës
- ✓ Implementimin e vendimit të KK Lipjanit për lagjen e kategorive të luftës së UQK-së
- ✓ Zgjerimin e qytetit në drejtim të lumit sitnica, si dhe rregullimin e shtratit të lumit, parqeve dhe pushimoreve përgjatë lumit në sipërfaqe 250 ha
- ✓ Punësimin e rasteve sociale;
- ✓ Sistemimin e veteranëve të luftës dhe kategorive të dala nga lufta;
- ✓ Përkrahjen e vazhdueshme të familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës;
- ✓ Krijimin e hapësirave ku rinia do të zhvillojë aktivitetet sportive dhe kulturore;
- ✓ Renovimin e shtëpisë së kulturës si dhe funksionimin e sferave të kulturës, si kinematografisë, artit skenik dhe të gjitha ato fusha që i kërkon rinia lipjanasve;
- ✓ Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit;
- ✓ Administratë digjitale;
- ✓ Renovimin e stadiumit të qytetit;
- ✓ Ngrohjen qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillaxhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundoj brenda tre vjeçarit të qeverisjes);
- ✓ Për fshatin Smallushë: rregullimin e gjithë infrastrukturës; ndërtimin e një shkolle të re dhe një fushe të futbollit;
- ✓ Për banorët e Gadimes: ndërtimin e një objekti të ri shkollor me përmasa më të mëdha dhe me ambiente më moderne; asfaltimin e të gjitha rrugëve të brendshme;
- ✓ Arsim cilësor duke ndërtuar infrastrukturës të shkollës me pedagog, mjek dhe psikolog dhe me ngrohje qendrore;
- ✓ Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës;
- ✓ Zhvillimin ekonomik sidomos në fushën e bujqësisë;
- ✓ Ndërtimin e dhjetë fabrikave;
- ✓ Zhvillimin e turizmit;

- ✓ Përpunimin e plehrave të pulave në mënyrë që të largohet era nga ferma e pulave.

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.

0 -tregon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,

1- tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit,

2- tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,

3- tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë,

4- tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe,

5- tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.

Vërejtje: Premtimet janë për periudhën katër vjeçare 2009/2012. Deri tani është shpenzuar 1/8 e kohës.

Premtimet	vlerësimi
Krijimi i zonës së re industriale në Kërqevë për akomodimin e 200 Bizneseve dhe punësimin e 2000 personave	1
Fillimin e ndërtimit të zonës industriale me sipërfaqe 20 ha afër QMI-së dhe punësimin e 800 personave	1
Krijimin e Lipjanit si qendër agrobiznese	0
Renovimin e të gjitha shkollave dhe krijimin e kushteve hapësinore për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasë nga 37 në 25	1
Rregullimin e parkingjeve publike	1
Zgjerimin e rrugëve kryesore të qytetit në katër korsi të qarkullimit	0
Asfaltimin e rrugëve në të gjitha lagjet e qytetit	2
Krijimin e hapësirave të mjaftueshme të parqeve si dhe parkingjeve publike	1
Futjen e rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrat mbi 150 km	2
Asfaltimin rrjetit rrugor mbi 70 km	1
Sistemin e rrjetit të ujësjellësit mbi 100 km	3
Ndërrimin e pllakave në dysheme, dyerve dhe dritareve në Q.K.M.F në Lipjan	0
Rregullimin e ngrohjes qendrore në Lipjan	0
Zvogëlimin e papunësisë dhe të varfërisë	0
Mbështetjen e ekonomive familjare	0
Riaktivizimin dhe pasurimin e bibliotekave shkollore	1
Hartimin e projekteve bujqësore	1
Rregullimin dhe zgjerimin e sheshit "Adem Jashari"	0
Krijimin e lehtësirave administrative dhe teknike për nxitjen e investimeve të huaja	0
Uljen e taksave mbi investimet që krijojnë vende pune	0
Renovimin e të gjitha shkollave dhe kompletimin me infrastrukturë me	1

qëllimtë krijimit të kushteve sipas standardeve evropiane	
Rregullimin e nxehtësisë qendrore në të gjitha shkollat dhe rregullimin e rrethëve të oborreve të shkollave sipas modelit të shkollës "Mehmet Akif"	0
Përmirësimin e infrastrukturës sportive	0
Sinjalizimin horizontal dhe vertikalë të rrugëve	5
Transporti publik urban dhe ndër urban me mjete transporti uniforme	2
Furnizimi të pandërprerë me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza	4
Ndriçimin e të gjitha rrugëve të qytetit	2
Zgjerimin e qytetit në drejtim të lumit sitnica, si dhe rregullimin e shtratit të lumit, parqeve dhe pushimoreve përgjatë lumit në sipërfaqe 250 ha	1
Implementimin e vendimit të KK Lipjanit për lagjen e kategorive të luftës së UQK-së	2
Përkrahje e vazhduar e familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës	4
Punësimin e rasteve sociale;	0
Sistemimin e veteranëve të luftës dhe kategorive të dala nga lufta;	2
Përkrahjen e vazhdueshme të familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës;	4
Krijimin e hapësirave ku rinia do të zhvillojë aktivitetet sportive dhe kulturore;	0
Renovimin e shtëpisë së kulturës si dhe funksionimin e sferave të kulturës, si kinematografisë, artit skenik dhe të gjitha ato fusha që i kërkon rinia lipjanase;	0
Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit;	0
Administratë digjitale;	0
Renovimin e stadiumit të qytetit;	0
Ngrohjen qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillaxhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundojë brenda tre vjeçarit të qeverisjes);	0
Për fshatin Smallushë: rregullimin e gjithë infrastrukturës; ndërtimin e një shkolle të re dhe një fushe të futbollit;	0
Për banorët e Gadimes: ndërtimin e një objekti të ri shkollor me përmasa më të mëdha dhe me ambiente më moderne; asfaltimin e të gjitha rrugëve të brendshme;	1
Arsim cilësor duke ndërtuar infrastrukturës të shkollës me pedagog, mjek dhe psikolog dhe me ngrohje qendrore;	0
Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës;	0
Zhvillimin ekonomik sidomos në fushën e bujqësisë;	0
Ndërtimin e dhjetë fabrikave;	0
Zhvillimin e turizmit;	0
Përpunimin e plehrave të pulave në mënyrë që të largohet era nga ferma e pulave;	0
Numri total i pikëve	

Problemet aktuale

Edhe pse një komunë me një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe me potenciale të mëdha për zhvillim ekonomik, qytetarët e Komunës së Lipjanit përballen me të njëjtat problema sikurse pjesa tjetër e Kosovës. Edhe në këtë komunë brenga më e madhe e qytetarëve mbetet papunësia dhe varfëria. 48.91% e qytetarëve në këtë komunë janë të papunë. 12.16% e qytetarëve janë të varur nga ndihmat sociale. Përveç këtyre problemeve, probleme më specifike për komunën e Lipjanit janë:

- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Mungesa e një parku dhe hapësirave gjelbëruese;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;
- Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Qyteti i Lipjanit nuk ka ngrohore. Ky qytet e ka pasur një ngrohore e cila është shkatërruar gjatë viteve të '80. Vitin e kaluar pjesët e mbetura të ngrohtores janë shitur për hekur dhe është pastruar i tërë vendi ku ka qenë dikur ngrohitorja. Gjatë fushatës paraelektorale të vitit 2007 ishte premtuar se do të ndërtohet një ngrohore e re e qytetit, por edhe gjatë fushatës paraelektorale të vitit 2009 është premtuar nga kryetari Shukri buja për ndërimin e një ngrohore qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillazhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundoj brenda tre vjeçarit të qeverisjes), mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Në këtë qytet të vogël, i cili është duke përjetuar një rritje të shpejtë falë pozitës së tij të përshtatshme gjeografike, ka ndërtesa të mëdha të banimit kolektiv të cilat kanë nevojë për ngrohje. Ndërtesat që janë ndërtuar para shumë viteve nxehjen e sigurojnë përmes drurëve, kurse ndërtesat e reja kanë të rregulluar ngrohjen me rrymë. Por, të gjithë banorët e ndërtesave të banimit kolektiv ankohen se ngrohja me rrymë është e kushtueshme, kurse ajo me dru nuk është e përshtatshme për ndërtesat e banimit kolektiv. Zgjidhjen ata e shohin tek një ngrohore qendrore e qytetit e cila do të ishte më e përshtatshme dhe më e lirë.

Mungesa e parkut dhe hapësirave gjelbëruese. Në qytetin Lipjanit tani së fundmi është shtruar rruga kryesore e qytetit, që nga hyrja në Lipjan e deri në qendër të qytetit. Mirëpo trotualet mbeten ende në gjendje jo të mirë dhe thuajse janë shkatërruar të gjithë, edhe pse ekzistojnë shtigjet për këmbësorë. Qytetarët ankohen se është e vështirë të ecet nëpër trotuar ngase është i mbuluar me lloç. Përveç trotuareve që janë në gjendje jo të mirë, qytetarët ankohen se në qytet nuk ka mjaft hapësira gjelbëruese. Në oborrin e objektit të komunës, në atë të objektit të policisë, në vendin ku ka qëndruar dikur ngrohitorja e qytetit, etj., ka hapësira të mbjellura me bari, por të cilat nuk mirëmbahen dhe qytetarët nuk kanë qasje në to. Në qytetin e Lipjanit ka hapësira të mjaftueshme ku mund të ndërtohet një park, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë deri më tani. Qytetarët, sidomos ata të moshave më të vjetra, ankohen se nuk kanë ku të shëtisin në qytet, për shkak se rrugët nuk janë të mirëmbajtura, ata nuk mund të qëndrojnë në lokalet e shumta për të rinjtë, dhe zgjidhja më e mirë sipas tyre do të ishte një park në qytet. Sipas personave përgjegjës në komunë, ekziston një projekt për ndërtimin e një parku i cili do të lidhej me lumin Sitnica, mirëpo është një projekt i kushtueshëm dhe nuk dihet se kur do të filloj së implementuari. Në anën tjetër, edhe shtrati i lumit Sitnica ka nevojë për përkujdesje. Shtrati i këtij lumi është mbuluar me shkurre dhe bërllok dhe pas çdo reshje të shiut ndodh që ky lum të del nga shtrati dhe të vërshoj tokat përreth tij.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimit të erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Janjeva është vendbanimi më i largët nga qyteti i Lipjanit. Për tërë këto vite nuk ka pasur investime në këtë fshat. Ky fshat është i banuar me banorë të komunitetit shqiptarë, kroat dhe rom. Problemi më i madh në këtë fshat është mungesa e kanalizimit. Ujërat e zeza të shtëpive të këtij fshati derdhen në një përroskë në afërsi dhe kjo bën që fshati të kundërmojë. Edhe Shpella e Gadimes si vendi më i vizituar turistik është jashtë përkujdesjes institucionale. Kjo shpellë menaxhohet nga një person privat i fshatit Gadime, i cili pretendon se shpella ndodhet në pronën e tij private. Nga 39 hektarët që ka hapësira e shpellës, 37 ndodhen në pronë publike të komunës. Mos futja e shpellës nën përkujdesje institucionale nga komuna e Lipjanit arsyetohet se kjo është kompetencë e nivelit qendror. Sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës, nenit 25.1, përfshirja e shpellave nën përkujdesje institucionale bëhet me vendim të Qeverisë së Kosovës. Në bazë të kësaj, në mars të këtij viti Qeveria e Kosovës me vendimin 04/57 ka futur shpellën e Gadimes nën përkujdesje institucionale. Ky vendim do të duhej të zbatohet nga ana e MAPH, mirëpo nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Gjendja në Shpellën e Gadimes nuk është në gjendje të mirë. Si pasojë e punës së gurthyesve afër shpellës, janë vërejtur qarje në shpellë, thyerje të kristaleve, dhe për shkak të dritës jo adekuate në koridore janë krijuar myshqe.

Përshkrim i realizmit të punëve

Kryetari i ri zgjedhur Shukri Buja e ka dhënë betimin për mandatin e ri me 26 shkurt 2010 dhe po të njëjtën ditë ka bërë emërimin drejtorëve komunal me të cilët do të udhëheqë në këtë mandat. Ku ndryshime kemi në rritjen e numrit të drejtorëve nga 10 të paraparë me statut komunal në 13 drejtori. Një numër i madh i drejtorëve janë të njëjtë me ata që kanë qenë pjesë e Qeverisë të udhëhequr po ashtu nga Kryetari Shukri Buja gjatë dy viteve të kaluara, ndërsa pjesë e Qeverisë së re, me mandat 4 vjeçar, janë tre drejtorë të emëruar nga partneri i koalicionit AKR, ndërsa tre drejtorë i është ndërruar drejtoria. Nënkryetar i Komunës së Lipjanit është rilemuar z. Florent Hoxha, i cili shërbeu gjithashtu edhe në mandatin e parë. Kemi po ashtu një ndryshim tek nënkryetari i komunës për komunitet që është zgjedhur nga komuniteti shumicë Banush Bytyqi nga partneri i koalicionit AKR.

Më 26 shkurt 2010, në seancën e parë të rregull të Kuvendit Komunal, Kryetari Shukri Buja ka paraqitur bashkëpunëtorët e tij, përkatësisht drejtorët e drejtorive si dhe ka paraqitur programin e tij për 4 vitet e ardhshme. Programi i paraqitur nuk respekton ndonjë format të caktuar, gjë që nuk krijon përshtypjen e një dokumenti serioz programor dhe strategjik të përcaktimit të politikave të qeverisë lokale për katër vite të qeverisjes. Më tutje, programit të paraqitur i mungonte metodologjia meqë nuk përcaktonte qartë objektivat, formën e arritjes së tyre, respektivisht veprimet konkrete në drejtim të përmbushjes së tyre. Gjithashtu planit i mungonte dhe planifikimi kohor si edhe ai buxhetor, në këtë aspekt, do të duhej të vendoseshin qartazi parametrat që duhen përmbushur çdo vit.

Ky program nuk ka dalluar shumë nga premtimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore, bile në disa aspekte më shumë detaje janë dhënë gjatë fushatës për projekte të caktuara sesa në programin.

EKZEKUTIVI I KOMUNËS SË LIPJANIT 2010		
Drejtoratet:	Udhëheqësi i drejtoratit	Profesioni
Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	Agim Bylykbashi	Profesor i gjuhës shqipe,
Drejtorati për Shërbime Publike	Avni Limani,	Ekonomist i diplomuar
Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari	Armend Agushi,	Fakultetin e kryer të shkencave matematiko natyrore,
Drejtorati për Inspeksion	Bajram Rizani,	shkollën e lartë - Matematikën,
Drejtorati për Urbanizëm	Edmond Rexhepi	inxhinjer i diplomuar i Komunikacionit,
Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Fitim Mziu	Doktor i Mjekësisë Familjare
Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër	Halit Gashi	Jurist i diplomuar,
Drejtorati për Prokurim	Ragip Zejnullahu,	Ekonomist i diplomuar
Drejtorati për Administratë i	Sefer Krasniqi	Magjistër i Shkencave Juridike
Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim	Haqif Drenica,	shkollën e lartë -Batin
Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	Mendim Luma	Ekonomist i diplomuar
Drejtorati për Arsim	Nazmi Krasniqi,	Kimist i diplomuar
Drejtorati për Buxhet dhe Financa	Petrit Kelmendi	Ekonomist i diplomuar

Gjendja ekonomike dhe sociale

Komuna e Lipjanit në mbledhjen e tretë të datës: 31 mars 2010 Kuvendi Komunal i Lipjanit e aprovon propozim vendimin për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2010-2015 dhe u formua komisioni i përbërë prej 11 anëtarësh , deputet dhe ekspertë të lëmive të ndryshme të cilët do të merren me hartimin e strategjisë Zhvillimore.

Gjendja ekonomike dhe Sociale në komunë e Lipjanit është shumë e vështirë edhe pse është premtuar nga kryetari Buja gjatë fushatës zgjedhore 2009 se do të punësojë mbi 5,000 persona gjatë periudhës katër vjeçare. Prapë kemi në një nivel të lartë të pa punëve. Ku në maj 2010 në Zyrën Komunale për Punësim i kemi të regjistruar 9,487 si të papunë. Kjo shifër do të thotë se është me madhe, ku kemi parasysh shumë raste që nuk janë të regjistruar në këtë zyre dhe numri total i të pa punëve në komunën e Lipjanit sillet diku në 28 mijë , afër 48% e popullatës.

Po ashtu kemi një numër të madhe të rasteve sociale. Ku në bazë të statistikave në muajin Maj të vitit 2010, kemi përfitues të asistencës sociale 1,598 familje me 7616 anëtarë diku mbi 12.16% e popullatës së përgjithshme të Komunës së Lipjanit. Krahësuar në mes periudhës Maj 2009 dhe Maj 2010 kemi një rritje me 117 familje me 594 anëtar të familjeve.

Problemi më i madh social në komunën e Lipjanit janë banorët Qendrës Kolektive Strehimore mirëpo ky problem pritet të zgjidhet së shpejti.

Numri i të papunëve të regjistruar në Zyrën komunal për Punësim në Lipjan			
Periudha kohore	Nr. Llogaritur i të pa punëve të cilët nuk janë të regjistruar	Të papunë të regjistruar në ZKP në Lipjan	Të punësuar nga ZKP në Lipjan
2008	24,000	10,014	184
2009	26,000	9,740	258
Maj 2010	28,000	9,487	76

Numri i familjeve përfituese të asistencës sociale në Komunën e Lipjanit		
Periudha kohore	familje	Anëtarë të familjeve
Maj 2009	1,481	7022
Maj 2010	1,598	7616

Transparenca dhe llogaridhënia

Ndër premtimet kryesore të Kryetarit Shukri Buja ka qenë edhe transparenca dhe llogaridhënia si dhe bashkëpunimi shoqërinë civile. Megjithatë transparenca e kësaj komune është në nivel më të mirë në krahasim me disa institucione dhe komuna të tjera, mbetet shumë për tu dëshiruar dhe përmirësuar në aspekt të llogaridhënies dhe transparencës.

Me 16 prill 2010 organizata YAHR ka dal me një komunikatë për media me konstatimin mangësive të shumat tek ekzekutivi i Kuvendit komunal rreth çështjes së transparencës së aktiviteteve të këtyre institucioneve.

1. Në bazë të rregullores komunale për transparenca të miratuar nga kuvendi Komunal të datës 20.03.2009. Neni 9. Alineja 9.1 ku thuhet: **Pas miratimit të kësaj Rregulloreje nga Kuvendi Komunal, Komuna duhet të hartojë Planin e veprimtimit për Transparenca Komunale.** Një gjë e tillë nuk është bërë, që 15 muaj nga miratimi i kësaj rregullore. Që në fakt na është thënë nga kryetari i komunës së ekziston një plan i tillë për transparenca. Por, ne pas shumë kërkesave drejtuar zyrës së kryetarit nuk na është përgjigjur dhe kontakteve me persona zyrtar se nuk na është dëshmuar se ekziston një plani i tillë.

2. Po ashtu kemi konstatuar mos prezantimin e aktiviteteve të Kuvendit komunal në dy webfaqet e saja; www.lipjan-komuna.org dhe www.kk.rks-gov.net/lipjan .Webfaqja www.lipjan-komuna.org nuk është rifreskuar që nga muaji shkurt 2010 dhe ka shumë mangësi. Që do të përmenden më poshtë. Ku në webfaqen www.kk.rks-gov.net/lipjan mungojnë të dhënat në rubrikën: Edukimi [Shëndetësia](#), [Ekonomia](#), [Shërbimet publike](#), [Mirëqenia sociale](#), [Inspektionet](#), [Shërbimet](#) (ku shënimet janë të komunës së Prishtinës), Tek rubrika Komuna, nuk kemi të dhëna për komitete, statutin, rregulloret, raportet, drejtoritë, raportin e kryetarit, agjenda e kryetarit, buxhetin, prokurimin, etj.

Po ashtu kemi një mos transparencë nga vizitat e shpeshta të Kryetarit të Komunës dhe stafit të tij në shtete të jashtme, ngase nga Kryetari nuk është dhënë asnjë informatë në Kuvend për vizitat e tij jashtë Kosovës dhe nuk janë bërë publike lidhur me qëllimin dhe arsyet e vizitave. Është për tu çuditur se një gjë të tillë nuk e kërkojnë deputete komunale për raportim të kryetarit lidhur me vizitat e tij jashtë shtetit!

Shkelje të procedurave ligjore është bërë nga Kuvendit Komunal i Lipjanit në rastin e miratimit të rregullores për transportin e udhëtarëve me automjet taxi. Ku kjo rregullore miratohet pa dalë në diskutim publikë në mbledhjen e katërt të Kuvendit komunal të Lipjanit me datën 29 Prill 2010. Këtu kemi shkelje të statutit të komunës së Lipjanit neni 64 alineja 1 dhe 2, rregullorja komunale për transparencë neni 6. në të cilën thuhet se para se të miratohet ndonjë rregullore Kuvendi Komunal është i obliguar që të hedhë draft rregulloren në diskutim publik . Një gjë e tillë nuk ka ndodhur, rregullorja është miratuar pa dalur dhe pa u konsultuar me publikun.

Po ashtu organizata jonë ka reaguar me anë të komunikatës për media lidhur me formën e ndarjes së subvencioneve për të ndihmuar studenteve, duke ju ndarë subvencione nga kryetari i komunës së Lipjanit, pa ndonjë shpallje publike për konkurrim të barabartë nga të gjithë studentet të cilët i kanë kushtet e vështira, gjithë ashtu pa komision, pa ndonjë kriter, diku, diku mungon arsyetimi i vendimit edhe notës mesatare ne vendimet që lëshohen nga organi i lartcekur. Kjo është një shkelje e të drejtave të njeriut për të qenë të barabartë me të gjithë qytetaret e komunës së Lipjanit dhe për të gëzuar të drejtën për përkrahje nga institucionet komunale si taksa pages.

Projektet e përcjella për realizim nga viti 2009

Disa projekte të përcjellura në vitin 2010 e që kanë mbetur në gjysmë nga viti i kaluar edhe gjatë kësaj periudhe 4 mujore janë duke u realizuar si P.SH: Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobrajë e Madhe, Asfaltimi i rrugës në fshatin Krojmir, Asfaltimi i rrugës Babushë, Asfaltimi i rrugës Rufc i Vjetër.

Komuna e Lipjanit duhet që të mbikëqyr realizimin e punëve në dinamikën e paraparë dhe të dialogoj me kompanitë e kontraktuara që punët të zhvillohen më shpejt, sikurse që duhet që punët e parapara për sivjet të fillojnë së realizuari.

Investimet e realizuara në infrastrukturën rrugore gjatë vitit 2009						
Nr	Titulli i projektit	Kostoja e projektit	Donatorët	Komuna	Në m ² , m	
1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobrajë e Madhe	591,672.14€ MTPT-ja	110,000.00 €	481,672.14 €	6370 m'	Në realizim
2	Asfaltimi i rrugës në fshatin Bujari	220,573.44 € -		220,573.44 €	3 3160 m'	Ka përfunduar
3	Asfaltimi i rrugës në fshatin Jeta e Re	79,883.88 €	-	79,883.88 €	1245 m'	Ka përfunduar
4	Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë	156,329.00 €	-	156,329.00 €	2050 m'	Ka përfunduar
5	Asfaltimi i rrugës „Kongresi i Blinajës dhe „Idriz Ajeti“ në Lipjan	175,998.00 €	-	175,998.00 €	860 m'	Ka përfunduar
6	Asfaltimi i rrugës në fshatin Mirenë	118,505.21 €	-	118,505.21 €	1640 m'	Ka përfunduar
7	Asfaltimi i rrugës në fshatin Krojmir	259,923.06 €	-	259,923.06 €	4500 m'	Në realizim
8	Zhavorrimi i rrugës Topliqan - Grakë e Vogël	8,145.00 €	KFORI 5,000.00	3,145.00 €	570 m'	Ka përfunduar
9	Zhavorrimi i rrugës Sillovi -Tërbovc	2,985.00 €	-	2,985.00 €	5200 m	Ka përfunduar
10	Zhavorrimi i rrugëve të qytetit të Lipjanit	8,064.80€	-	8,064.80 €	1200 m'	Ka përfunduar
11	Zhavorrimi i rrugëve Gadime,Banullë,Ribar i M.Smalush, Vrellë,Sillovi	25,744.00 €	-	25,744.00 €	6436 m'	Ka përfunduar
12	Asfaltimi i rrugës Babushë	269,629.69 €	MTPT 200,000.00 €	69,629.69 €	4300 m'	Në realizim
13	Asfaltimi i rrugës Rufc i Vjetër	450,000.00€	MTPT 400,000.00 €	50,000.00 €	3000 m'	Në realizim
14	Asfaltimi i rrugëve “Lidhja e Prizrenit”, “Zylfije Gashi”, “Tahir Sinani”, “Malet e Sharrit”	237,316.52 €	-	237,316.52 €	1720 m'	Ka përfunduar
15	Asfaltimi i rrugës në fshatin Blinajë	160,147.30 €	-	160,147.30 €	1625 m'	Ka përfunduar
16	Zhavorrimi i rrugëve në fshatin Brusë	35,532.00 €		35,532.00 €	2600 m'	Ka përfunduar
17	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	19,500.00 €	-	19,500.00 €		Ka përfunduar

Totali	2,819,949.04€	715,000.00€	2,104,949.00€	46476 m'	
---------------	----------------------	--------------------	----------------------	-----------------	--

Investimet të tjera të realizuara nga DSHP-ja gjatë vitit 2009						
Nr	Titulli i projektit	Kostoja e projektit	Donatorët	Komuna	Në m2 ,m	
1 -	Renovimi i Varrezave Ribar i Vogël	15,310.00 €	-	15,310.00 €		Ka përfunduar
3	Ndërtimi i Shkollës Fillore Dobrajë e Vogël	58,642.00 €	-	58,642.00 €	260 m2	Ka përfunduar
4	Renovimi i varresave të martirëve në Sllovi	45,000.00 €	-	45,000.00 €	-	Ka përfunduar
5	Ndërtimi i Shkollës Fillore në Resinovec	144,480.00 €	-	144,480.00 €	516 m2	Ka përfunduar
6	Ndërtimi i fushës sportive në Ribar i M	8,466.00 €	-	8,466.00 €	1250 m2	Ka përfunduar
7	Ndërtimi i QMF-së në Gadime	87,000.00 €	-	87,000.00 €	-	Ka përfunduar
8	Rregullimi i nxemjes qendrore dhe rrethoja e QMF në Gadime	21,532.00 €	-	21,532.00 €	-	Ka përfunduar
Totali		394.102,14 €	-	94.102,14 €		

Buxheti i Komunës

Që nga viti 2004 e deri më 2008, buxheti total i komunës së Lipjanit është vërtitur brenda shifrës 5 milion €. Përveç në vitin 2006, në të gjitha vitet tjera buxheti i përgjithshëm i komunës ka shënuar rritje. Rritja më e madhe e buxhetit është bërë më 2010, ku për herë të parë në këtë komunë buxheti ka arritur në mbi 8.4 milion € krahasur me vitin 2009 kemi ngritje pwr 1 milion €. Po në 2010, edhe shpenzimet për rroga dhe mëditje kanë shënuar një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet tjera. Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit në vitin 2009 ka arrit që të shpenzohet në masën 93%. Kjo shifër është shifra më e lartë që është arritur ndonjëherë në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e shpenzimeve janë realizuar në tre mujorin e fundit të 2009, kurse deri në fund të shtatorit 2009 vetëm 62.4% e mjeteve ishin shpenzuar Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake, Komuna e Lipjanit zë vendin e parë në krahasim me komunat tjera. Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2008 ka arritë që të arkëtoj të hyrat vetanake në krahasim me planifikimet për 178.76%. Kjo është shifra më e lartë që një komunë ka arritur që të regjistroj me rastin e arkëtimit të të hyrave vetanake në 2008. Të hyrat për gjashtë mujorin e parë të 2009 janë për 11% më të larta se të hyrat për të njëjtën periudhë 2008.

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzim et komunale	Subvencion et dhe transferet	Shpenzim et kapitale	Gjithsej
-------------	----------------------------	------------------------------	-----------------------------	-------------------------------------	-----------------------------	-----------------

2010	4,758,026 ▲	513,941 ▲	118,443 ▼	80,000 ■	2,986,007 ▲	8,456,417 ▲
2009	4,425,264 ▲	512,394 ▼	112,154 ■	80,000 ■	2,325,154 ▲	7,454,966 ▲
2008	3,868,282 ▲	554,288 ▲	112,154 ▼	80,000 ■	1,239,909 ▲	5,854,633 ▲
2007	3,718,294 ▼	537,335 ▼	202,154 ▲	80,000 ▼	1,127,138 ▲	5,664,921 ▲
2006	3,731,341 ▲	610,147 ▼	78,577 ▼	100,000 ▲	1,070,849 ▼	5,590,914 ▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381 ■	64,000 ■	1,180,077 ▲	5,689,281 ▲
2004	3,701,207 ▲	1,135,854 ▼	-	-	721,431 ▲	5,558,492 ▲
2003	2,770,014 ■	1,144,006 ■	-	-	465,113 ■	4,528,532 ■

Investimet kapitale

Buxheti i komunës i destinuar për investime kapitale deri në fund të 2008 asnjëherë nuk e ka kalu shifrën 1.2 milion euro. Krahas rritjes së buxhetit të përgjithshëm të komunës më 2009, edhe kategoria e investimeve kapitale ka shënuar rritje. Buxheti për investime kapitale këtë vit është pak më shumë se 2.3 milion euro. Në vitin 2008 Komuna e Lipjanit ka arritur që buxhetin e destinuar për investime kapitale ta realizoj në masën 81%, kurse deri në fund të shtatorit buxheti për investime kapitale ishte shpenzuar në masën 42.2%. Sipas kësaj, gjysma e mjeteve të shpenzuara për projekte kapitale është shpenzuar në tre mujorin fundit. Në periudhën janar-qershor 2010, buxheti i ndarë për investime kapitale është realizuar në masën 35.6%..Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010- 2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Lipjanit do të ketë në dispozicion **9,612,623 €** për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari I ardhshëm i komunës së Lipjanit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth **13.1 milion €** për investime kapital.

Lista e projekteve për investime publike për vitin 2010			
Nr.	Emri i projektit	Gjatësia e rrjetit	Vlera e projektit në €
1	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Kojskë	2000	150,000.00
2	Asfaltimi i rrugës „Halil Metaj" Lipjan	636	102,640.00
3	Asfaltimi i rrugës „Dr.Avdi Avdiu" Lipjan	78	18,720.00

4	Asfaltimi i rrugës „Vezir Kolshi" Lipjan	95	22,800.00
5	Asfaltimi i rrugës „Ramiz Shala" Lipjan	99	23,760.00
6	Asfaltimi i rrugës „Adem Gllavica" Lipjan	220	52,800.00
7	Asfaltimi i rrugës „Qerim Banulla" Lipjan	172	41,280.00
8	Asfaltimi i rrugës „Haxhi Kleqka" Lipjan	364	67,360.00
9	Asfaltimi i rrugës „Avdi Kelmendi" Lipjan	296	79,040.00
10	Asfaltimi i rrugës „Enver Olluri" Lipjan	192	46,080.00
11	Asfaltimi i rrugës së fshatit Grackë e Vogël	1500	80,000.00
12	Asfaltimi i rrugës në fshatin Rubovc-Llugaxhi	1000	45,500.00
13	Asfaltimi i rrugës në fshatin Brus	2000	60,000.00
14	Asfaltimi i rrugës Krojmir faza II	2500	50,000.00
15	Asfaltimi i rrugës „Aleksandër Stipqeviq" Lipjan	210	55,000.00
16	Ndërtimi i kanalizimit në Lagjen e Akllapit -Lipjan	3000	90,000.00
17	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Kraishtë, Bujan dhe Grackë e Vogël	16000	150,000.00
18	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Sllovi	8000	100,000.00
19	Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Banullë-Gllogovc	7000	217,500.00
20	Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Torin-Poturovc faza I	4500	120,000.00
21	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Shalë	8000	130,000.00
22	Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Ribar i Madh dhe një pjesë e mbetur në Ribar të Vogël	7500	150,000.00
23	Mirëmbajtja e rrjetit ujësjellësit Resinoc	2500	16,000.00
24	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Topliqan	2200	100,000.00
25	Ndërtimi i kanalizimit në Gadime e Ulët dhe Gadime e Epërme	12000	130,000.00
26	Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të kategorisë së IV		15,000.00
27	Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara		10,000.00
28	Pastrimi i bores nga rrugët		35,000.00
29	Rregullimi i parkut të Qytetit-Lipjan		50,000.00
30	Lidhja e institucioneve Komunale me trafon Kryesore-Lipjan		40,000.00
31	Mirëmbajtja e shenjëzimit vertikal dhe horizontal të trafikut		25,000.00
32	Mirëmbajtja e ndriçimit publik të rrugëve		10,000.00
TOTALI - 2010			2,283,480.00

Projektet që janë të kontraktuara me punëkryerësin deri me 1 Qershor 2010	
1	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Kojskë
2	Asfaltimi i rrugës „Halil Metaj" Lipjan
3	Asfaltimi i rrugës „Dr.Avdi Avdiu" Lipjan
4	Asfaltimi i rrugës „Vezir Kolshi" Lipjan
5	Asfaltimi i rrugës „Qerim Banulla" Lipjan
6	Asfaltimi i rrugës „Adem Gllavica" Lipjan
7	Asfaltimi i rrugës „Ramiz Shala" Lipjan
8	Asfaltimi i rrugës së fshatit Grackë e Vogël
9	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Shalë
Projektet që janë në proces të tenderimit deri me 1 Qershor 2010	
1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Rubovc-Llugaxhi
2	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Sllovi
3	Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Torin-Poturovc faza I
4	Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Ribar i Madh dhe një pjesë e mbetur në Ribar të Vogël

Administrata komunale

Në vitin 2010, në Komunën e Lipjanit, në tre sektorët publik (arsim 1,068, shëndetësi 233, administratë 182) janë të punësuar 1,483 qytetarë. Ky numër është zvogëluar në krahasim me një vit më parë. Vetëm në administratën komunale janë të punësuar 182 shërbyes civil. Numri i shërbyesve civil në administratën lokale është rritur në krahasim me një vit më parë. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46, ku sipas së cilit në komunat me popullsi nën 100,000 banorë administratat lokale duhet të kenë 1 shërbyes civil për 620 banorë, del se komuna e Lipjanit me rreth 60,000 banorë duhet të ketë më së shumti 97 shërbyes civil. Sipas kësaj, administrata komunale e Lipjanit është e tej ngarkuar me staf. Në mbledhjen e tretë me datën 31 mars 2010 është miratuar nga e Kuvendit komunal propozim vendimi për nxjerrjen e strukturës organizative të administratës së Komunës. Por, ky proces ende nuk ka përfunduar.

Komuna e Lipjanit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, brenda vitit Kuvendet Komunale duhet të mbajnë së paku dhjetë mbledhje të rregullta. Kuvendi Komunal i Lipjanit gjatë periudhën janar-qershor 2010 ka mbajtur 5 mbledhje. KK i Lipjanit ka miratuar një rregullore komunale gjatë 2010. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) në pjesën e parë të vitit 2010 ka mbajtur pesë mbledhje. Komiteti për Komunitete ka mbajtur një takime në pjesë e parë të vitit 2010 dhe. Përveç këtyre dy komiteteve KK i Lipjanit ka të formuara edhe tri komitete tjera dhe një komitet të përkohëshëm i cili do të mirrej me organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve nëpër 62 fshatra për ti zgjedhur këshillat e

fshtreve. Por nuk ka të formuar asnjë komitet konsultativ, ashtu siç kërkohet me ligj. Gjatë pjesës së parë të vitit 2010 Kryetari i Komunës ka mbajtur një tubim publike. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare kjo komunë ka pasur dy kërkesë pjesës së parë të vitit 2010 dhe atë vetëm nga organizata YAHR.

Ueb faqja e komunës së Lipjanit ka mungesa të konsiderueshme informacionesh të cilat do t'i nevojiteshin çdo qytetari rreth aktiviteteve të komunës siç janë, p.sh.: shërbimet komunale gati nuk janë të paraqitura fare, projektet komunale nuk mund të gjenden fare, si dhe në pikëpamje të strukturës organizative ueb faqja ka mangësi të mëdha.

Gjendja në arsim

Në Komunën e Lipjanit arsimi zhvillohet në dy nivele, në atë fillor dhe të mesëm. Në këtë komunë funksionon një çerdhe për fëmijë, 56 shkolla fillore (22 shkolla amë me 34 paralele të ndara) dhe 4 shkolla të mesme (3 shkolla amë me një paralele të ndarë). Gjatë pjesës së parë të vitit 2010 komuna ka filluar ndërtimin e shkollave fillore në: Gadime, Blinajë (është në procedurë të tenderimit) dhe putorovc dhe është bërë renovimi i shkollës fillore në Babushë.

Edhe pse gjatë vitit 2009 shumë është folur që do të ndërtohet edhe një qendër universitare, nuk kemi asnjë lëvizje në vitin 2010. Komuna I ka ndarë 5 hektar tokë një institucioni turk të arsimit të lartë QEA "Gulistan".

Gjendja në shëndetësi

Në Komunën e Lipjanit funksionojnë një QKMF, 4 QMF dhe 6 ambulanta të mjekësisë familjare. Vetëm në QKMF në qytetin e Lipjanit punohet me orar 24 orësh, kurse në QMF punohet pesë ditë në javë për 12 orë në ditë. Tri ambulanta punojnë vetëm dy ditë në javë për tetë orë në ditë. Në shëndetësinë primare të Lipjanit janë të punësuar 233 punonjës, prej tyre 122 femra, ku vetëm një femrë është në pozitë udhëheqëse. Sipas vetë zyrtarëve të drejtoratit, Lipjani ka mjaft kuadro shëndetësore, ka 17 specializant të mjekësisë familjare. Në mungesë të një spitali regjional në Prishtinë, rastet më të rënda të gjithë drejtohen në QKUK.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përllogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;

2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ndalimi i ndërhyrjeve Politike në Zyrën e Prokurimit Publik;
4. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
5. Komunikim më kualitativ me media;
6. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;
7. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;
8. Këshilltarët komunal të jenë më shumë përfaqësues të qytetarëve se pjesëtarë të pozitës apo opozitës;
9. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
10. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukturore;
11. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
12. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, Statutit komunal, Ligjit për transparencë dhe Rregullores komunale për transparencë të datës 20.03.2009. Duhet dhe është obliguar komuna të publikojë informacionet mbi aktivitet që është duke i zhvilluar.
13. Kuvendi Komunal I Lipjanit është i obliguar nga vetë rregullorja që e ka miratuar të datës 20.03.2009. dhe nga ligji për vetëqeverisje lokale, statuti komunal, Udhëzimi administrativë të MPL 2008/03. Që sa më shpejtë të hartojë një plan të veprimit për transparencë të aktiviteteve të saj karshi qytetarëve të saj.
14. Ne nuk jemi kundër ndarjes së subvencioneve për studentet me kushtet të vështira dhe e përkrahim institucionet komunale për të ju ndihmuar studenteve dhe të tjerëve. Por, duhen paraprakisht të informohen të gjithë studentet, dhe të caktohen kriteret të cilët duhen plotësuar për konkurrim dhe këto bursa ti ndajë një komision i pavarur.

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Maj, 2010.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mefrks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);

3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2009 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
14. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.
16. Programi zgjedhor i PDK-së dega Lipjan , Nëntor 2009,
17. Raporti Komunal Lipjan i Institutit për studime të Avancuara GAP , Tetor 2009,
18. Zyra Komunale për punësim në Lipjan. Maj 2010,
19. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Shkurt-Qershor 2010